



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 gusht 2019
Nr. ref.:RK 1419/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI77/17

Parashtrues

z. Šerif Aga

Zëvendëskryetar për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Dragashit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit Komunal të Dragashit, 01. nr. 06-368/1, të 21 marsit 2012, dhe Vendimit të Kuvendit Komunal të Dragashit, 01. nr. 06-1281/1, të 8 gushtit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Šerif Aga, Zëvendëskryetar për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Dragashit (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

2. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka bashkëngjitur kërkesës një petition të nënshkruar nga 311 (treqind e njëmbëdhjetë) qytetarë të Gorës, përmes të cilit kërkojnë *“nga të gjitha institucionet kompetente shtetërore, në të gjitha nivelet e qeverisë ta ndalojnë ndërtimin e një hidrocentralit në zonën e fshatit Vranishtë”*.

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesi i kërkesës e konteston Vendimin [01. nr. 06-368/1] e 21 marsit 2012 dhe Vendimin [01.nr.06-1281/1] e 8 gushtit 2012 të Kuvendit Komunal të Komunës së Dragashit (në tekstin e mëtejme: Kuvendi Komunal), përmes të cilave u shpall interesi i përgjithshëm publik dhe u përcaktua shpronësimi i një numri të parcelave kadastrale me qëllim të ndërtimit të tubacioneve të ujit, rrugëve hyrëse dhe largpërçuesve të energjisë elektrike për hidrocentralet përkatëse.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë të dy Vendimeve të kontestuara të Kuvendit Komunal, përmes të cilave sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të komuniteteve joshumicë të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor] dhe 58 [Përgjegjësitë e Shtetit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 62 [Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal] të Kushtetutës dhe rregullin 79 [Kërkesa në pajtim me nenin 62.4 të Kushtetutës] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

7. Më 3 korrik 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 6 korrik 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

9. Më 28 korrik 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të paraqesë në Gjykatë dokumente shtesë që provojnë se ai, si Zëvendëskryetar për Komunitete të Kuvendit Komunal, në pajtim me nenin 62 të Kushtetutës, kërkoi *“rishqyrtimin”* e Vendimeve të kontestuara nga Kuvendi Komunal.
10. Më 28 korrik 2017, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kryesuesit të Kuvendit Komunal dhe e ftoi që t'i parashtrojnë komentet e tyre në lidhje me pretendimet të cilat parashtruesi i kërkesës i kishte paraqitur në kërkesë.
11. Më 3 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës në Gjykatë dorëzoi dokumentet shtesë në vijim: (i) kërkesën për mbledhjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të 21 qershorit 2017, me një pikë të rendit të ditës ku kërkohet që *“për shkak të situatës së re në ndërtimin e hidrocentralit në fshatin Vraniq”*, të anulohen të dy vendimet e kontestuara; (ii) ftesën për mbledhjen e seancës së VII-të të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të 21 qershorit 2017; dhe (iii) procesverbalin e seancës së VII-të të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të 23 qershorit 2017, sipas të cilit me shumicën e votave është refuzuar kërkesa për anulimin e Vendimeve të kontestuara. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatë edhe plotësimin e kërkesës fillestare me argumente shtesë.
12. Më 14 gusht 2017, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës për herë të dytë që të dorëzojë në Gjykatë dokumentet e mëposhtme: (i) procesverbalin nga seanca kur është miratuar Vendimi [01. nr. 06-368/1] i kontestuar i 21 marsit 2012 i Kuvendit Komunal; kërkesën me shkrim të Zëvendëskryetarit për Komunitete të Kuvendit Komunal nga viti 2012, përmes të cilës është kërkuar *“rishqyrtimi”* i vendimit apo aktit (nëse është paraqitur kërkesa për rishqyrtim); (iii) Vendimin e Kuvendit Komunal sipas kërkesës për *“rishqyrtim”* të Vendimit të kontestuar (nëse ka pasur kërkesë për rishqyrtim); (iv) procesverbalin nga seanca kur është miratuar Vendimi [01. nr. 06-1281/1] i kontestuar i 8 gushtit 2012 i Kuvendit Komunal; (v) kërkesën me shkrim të Zëvendëskryetarit për Komunitete të Kuvendit Komunal nga viti 2012, me të cilën është kërkuar *“rishqyrtimi”* i vendimit apo aktit (nëse është paraqitur kërkesa për rishqyrtim); dhe (vi) Vendimin e Kuvendit Komunal sipas kërkesës për *“rishqyrtim”* të Vendimit të kontestuar (nëse ka pasur kërkesë për rishqyrtim).
13. Më 28 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatë dokumentet si në vijim: (i) Procesverbalin nga seanca kur është miratuar Vendimi [01. nr. 06-368/1] i Kuvendit Komunal të 21 marsit 2012; dhe (ii) Procesverbalin nga seanca kur është miratuar Vendimi [01. nr. 06-1281/1] i Kuvendit Komunal të 8 gushtit 2012.
14. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
15. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

16. Më 7 maj 2019, duke qenë se katër gjyqtarëve të lartpërmendur u kaloi mandati i tyre si gjyqtarë të Gjykatës, Kryetarja e Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, nxori Vendimin KSH.KI77/17, për zëvendësimin e gjyqtarit Ivan Čukalović me gjyqtaren Artë Rama-Hajrizi.
17. Më 22 korrik 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Procedura gjatë mandatit të Kuvendit Komunal të dalë nga zgjedhjet e vitit 2009

18. Më 6 korrik 2011, Kuvendi Komunal shqyrtoi kërkesën e Kompanisë “Eurokos” për ndërtimin e hidrocentraleve, duke dhënë pëlqimin që në zonën e Komunës së Dragashit, në rajonin e lumit të Brodit dhe Restelicës, të ndërtohen 6 (gjashtë) minihidrocentrale. Sipas shkresave të lëndës, rezultoi se më 18 tetor 2011, Kuvendi Komunal kishte miratuar vendimin për shpalljen e zonës në interes publik dhe vendosjen e tubacioneve në zonat ku do të ndërtohen hidrocentralet. Këto vendime ishin shqyrtuar përsëri më 22 shkurt 2012, duke e konfirmuar dhënien e pëlqimit të Kuvendit Komunal për ndërtimin e hidrocentraleve përkatëse.
19. Më 21 mars 2012, Kuvendi Komunal, për shkak të ndërtimit të tubacionit të ujit dhe rrugëve hyrëse për hidrocentralet, nxori Vendimin [01. nr. 06-368/1] për shpalljen e interesit të përgjithshëm dhe përcaktoi shpronësimin e një numri të ngastrave kadastrale në fshatrat Brod, Dikancë, Mlikë, Baçkë, Kukjan, Vranishtë, Krushevë, Restelicë dhe Globoçicë. Ky Vendim u miratua njëzëri në seancën e III-të të Kuvendit Komunal.
20. Më 8 gusht 2012, Kuvendi Komunal sërish shqyrtoi Vendimin e 21 marsit 2012 sepse i njëjti ishte kthyer në rishqyrtim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (në tekstin e mëtejme: MAPL) dhe sërish nxori Vendimin [01. nr. 06-1281/1] për shpalljen e interesit të përgjithshëm dhe përcaktoi shpronësimin e një numri të parcelave kadastrale në fshatrat Brod, Dikancë, Mlikë, Baçkë, Kukjan, Vranishtë, Krushevë, Restelicë dhe Globoçicë. Ky Vendim u miratua me shumicën e votave, përkatësisht 20 vota për, 4 abstenime dhe 1 votë kundër, në seancën e VIII-të të Kuvendit Komunal.
21. Në të dy Vendimet u përcaktua se “*Kompensimi për shpronësimin e të gjitha ngastrave kadastrale nëpër të cilat kalojnë tubacionet e ujërave për hidrocentralet, lokacionet, linjat e largpërçuesit të rrymës si dhe dëmet e shkaktuara gjatë punimeve do të kompensohen nga subjekti kërkues, në këtë rast Konzerciumi “Eurokos JH & Loreto Consult AG” Zug-Zvicër*”.
22. Në një datë të paspecifikuar, Kryetari i Komunës së Dragashit i dorëzoi MAPL-së një kërkesë për vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit [01.nr.06-1281/1] të 8 gushtit 2012. MAPL-ja kërkoi nga Departamenti i Shpronësimit i Ministrisë së Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejme: MMPH) që të vlerësojë ligjshmërinë e këtij Vendimi të Kuvendit Komunal.

23. Më 22 gusht 2012, Departamenti i Shpronësimit i MMPH-së konstatoi se Vendimi i Kuvendit Komunal të Dragashit ishte në përputhshmëri me ligjin e aplikueshëm.
24. Më 26 shtator 2012 dhe 1 tetor 2012, respektivisht, Kryetari i Komunës së Dragashit ngriti dy padi. Përmes të parës e kontestoi Vendimin e lartcekur të Departamentit për Shpronësim të MMPH-së në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme); ndërsa përmes të dytës, kontestoi të njëjtin Vendim në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prizren, me pretendimin se i njëjti është në kundërshtim me një numër dispozitash të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronave të Paluajtshme (në tekstin e mëtejme: Ligji për Shpronësimin) dhe të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (në tekstin e mëtejme: LVL). Më 23 janar 2013, Konsorciumi *"Eurokos JH & Loreto Consult AG" Zug – Zvicër* paraqiti parashtresë në Gjykatën Themelore të Prizrenit, duke kërkuar *"njohjen e cilësisë së palës së interesuar për hyrje në konflikt"*, i cili në këtë gjykatë zhvillohej në mes të Komunës së Dragashit, si paditëse dhe MMPH-së, si e paditur.

Procedura gjatë mandatit të Kuvendit Komunal të dalë nga zgjedhjet e vitit 2013

25. Më 10 mars 2015, Kryetari i Komunës nxori Vendimin [04. nr. 463-22/2012] për shpronësimin e pronave të paluajtshme me qëllim të ndërtimit të 6 (gjashtë) hidrocentraleve në lumin Brod dhe Restelicë nga Konsorciumi *"Eurokos JH & Loreto Consult AG" Zug – Zvicër*, bazuar në Vendimet e kontestuara, Vendimin [01. nr. 06-368/1] e 21 marsit 2012 dhe Vendimin [01. nr. 06-1281/1] e 8 gushtit 2012 të Kuvendit Komunal, respektivisht.
26. Më 10 mars 2017, banorët e fshatrave Rapqë dhe Kërstec iu drejtuan Degës në Dragash të Gjykatës Themelore, duke paditur Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e Komunës. Paditësit, ndër të tjera, pretenduan (i) shkelje të Ligjit për Shpronësimin, sepse sipas pretendimit, në bazë të paragrafit 3 të nenit 4 të këtij ligji, vetëm Qeveria është e autorizuar të bëjë shpronësimin e pronës për qëllime të ligjshme publike, dhe se rrjedhimisht, në marrjen e Vendimit për shpronësimin, Kuvendi Komunal ka vepruar jashtë kompetencave të tij; (ii) shkelje të procedurave të përcaktuara me këtë ligj, sepse sipas paditësve, procesi i shpronësimit ishte zhvilluar pa konsultim me pronarët e pronave të shpronësuar; dhe se (iii) sipas paditësve, shpronësimi mund të bëhet vetëm në dobi të shtetit dhe jo në dobi të personave privat, siç është në rastin konkret me Konsorciumin *"Eurokos JH & Loreto Consult AG" Zug – Zvicër*.
27. Më 21 qershor 2017, Zëvendëskryetari për Komunitete së bashku me një numër të asambleistëve që përfaqësojnë komunitetin joshumicë, kërkuan mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme në Kuvendin Komunal për të diskutuar Vendimin për shpronësimin e vitit 2015 dhe Vendimet e kontestuara të vitit 2012.

28. Më 23 qershor 2017, u mbajt seanca e VII-të e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal me një pikë të rendit të ditës, përkatësisht *“situatën e re të krijuar në fshatin Vraniq me rastin e ndërtimit të hidrocentralit”*, ku gjithashtu u kërkuar anulimi i (i) Vendimit [01. nr. 06-368/1] të 21 marsit 2012 të Kuvendit Komunal; (ii) Vendimit [01. nr. 06-1281/1] të 8 gushtit 2012 të Kuvendit Komunal; dhe (iii) Vendimit [04. nr. 463-22/2012] të 10 marsit 2015 të Kryetarit të Komunës për shpronësimin e pronave përkatëse.
29. Në seancën e jashtëzakonshme të lartpërmendur me shumicë votash u hodh poshtë kërkesa për anulimin e Vendimeve të kontestuara të Kuvendit Komunal. Sipas procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme në favor të anulimit votuan 8 (tetë) anëtarë, 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë votuan kundër, ndërsa 2 (dy) anëtarë abstenuan.

Vendimi për Pezullimin dhe Shfuqizimi përkatës i tij

30. Më 29 qershor 2017, Kuvendi Komunal miratoi Vendimin [nr. 060-01-10846/3], duke pezulluar përkohësisht punimet për ndërtimin e hidrocentraleve.
31. Më 3 korrik 2017, MAPL e dërgoi Vendimin [nr. 060-01-10846/3] e lartcekur të Kuvendit Komunal për vlerësim të ligjshmërisë në MMPH.
32. Më 8 gusht 2017, MMPH përmes shkresës [VI-020-895/5] komunikoi se Vendimi [nr. 060-01-10846/3] i Kuvendit Komunal lidhur me pezullimin e përkohshëm të punëve për ndërtimin e hidrocentralit ishte në kundërshtim me legjislacionin e aplikueshëm. Kjo Ministri konstatoi se nuk ka bazë ligjore për pezullimin e përkohshëm të punëve dhe se Gjykata Themelore në Prizren, përmes Aktvendimit [CN.nr.59/17] e kishte hedhur poshtë kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme.
33. Përmes të njëjtit akt, MMPH i propozoi MAPL-së që të kërkojë nga Kuvendi Komunal të ndërmarrë veprime konkrete me qëllim të harmonizimit të aktit komunal me legjislacionin në fuqi dhe këtë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pranimit të shkresës. MAPL përmes shkresës [nr. 020-895/5] të 8 gushtit 2017 e informoi Kryetarin e Komunës për vendimin e MMPH-së dhe kërkoi nga Komuna që ta informojë zyrtarisht për veprimet konkrete të ndërmarra.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përkundër faktit që sipas regjistrimit të popullsisë në Komunën e Dragashit jetojnë 43% të komuniteteve joshumicë, përfaqësuesit e tyre janë në mënyrë të vazhdueshme të mbivotuar në Kuvendin Komunal dhe rrjedhimisht të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë nuk janë të respektuara. Në këtë kontest, parashtruesi i kërkesës pretendon se Vendimet e kontestuara të Kuvendit Komunal, respektivisht Vendimi [01. nr. 06-368/1] i 21 marsit 2012 dhe Vendimi [01. nr. 06-1281/1] i 8 gushtit 2012, janë në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të

Paanshëm], 46 [Mbrojta e Pronës], 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor] dhe 58 [Përgjegjësitë e Shtetit] të Kushtetutës.

35. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës, parashtuesi i kërkesës pretendon se komunitetet joshumicë në Komunën e Dragashit janë diskriminuar, sepse të njëjtëve *“nuk u është dhënë e drejta që si qytetarët e tjerë të Kosovës të deklarohen për të drejtat e tyre”*.
36. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, parashtuesi i kërkesës pretendon se *“qytetarëve nuk u është mundësuar që në pajtim me të drejtën kushtetuese të marrin pjesë në mënyrë aktive, të paanshme dhe me vullnetin e tyre, si dhe pa asnjë ndikim politik në dhënien e pajtimin për ndërtimin e hidrocentraleve dhe shpronësimin e tokës”*.
37. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës, parashtuesi i kërkesës pretendon se Kuvendi Komunal ka bërë shpronësimin e pronës private pa e përcaktuar qëllimin publik për shpronësimin e këtyre pronave.
38. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 52 të Kushtetutës, parashtuesi i kërkesës pretendon se (i) Kuvendi Komunal nuk ka marrë pëlqimin e banorëve për ndërtimin e hidrocentraleve përkatëse; dhe se (ii) firma private, përkatësisht Konsorciumi *“Eurokos JH & Loreto Consult AG Zug – Zvicër”*, sipas Vendimeve të kontestuara merr në dispozicion lumin për eksploatim dhe ndërtimit të hidrocentraleve, dhe si pasojë *“do të dëmtohet në mënyrë të konsiderueshme i tërë ekosistemi në këtë zonë dhe do të ndodh çrregullimi i botës bimore dhe shtazore”*. Në këtë drejtim, parashtuesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), pa iu referuar ndonjë rasti specifik, për të argumentuar se, sipas kësaj praktike, vendimmarrja në raste të tilla e të cilat kanë efekt në mjedisin, duhet të bazohet në *“hulumtimet dhe studimet e duhura për t’iu mundësuar paraprakisht t’i parashikojnë dhe vlerësojnë ndikimin e këtyre aktiviteteve e të cilat do të kishin mundur të dëmtojnë mjedisin jetësor dhe t’i shkelin të drejtat e individëve”*.
39. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 58 të Kushtetutës, specifikisht paragrafit 4 të tij, parashtuesi i kërkesës pretendon se shteti ka dështuar të miratojë masa adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Në këtë drejtim, parashtuesi i kërkesës pretendon se ankesat dhe peticionet e qytetarëve kundër Vendimeve të kontestuara nuk ishin marrë parasysh nga organet shtetërore.
40. Në fund, parashtuesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të deklarojë kërkesën e pranueshme dhe të vërtetojë se *“... vendimet e Kuvendit të Komunës së Dragashit kanë shkelur nenet 24, 31, 46, 52 dhe 58 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*.

Pranueshmëria e kërkesës

41. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe të përcaktuara më tej me Rregullore të punës.

42. Në këtë aspekt, Gjykata së pari i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

43. Gjykata më tej i referohet paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 62 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“3. Zëvendëskryetari për komunitetet, do të promovojë dialog ndërmjet komuniteteve dhe shërben si pikë formale e kontaktit për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve që nuk janë shumicë në takimet e Kuvendit të Komunës dhe në punët e saj. Zëvendëskryetari gjithashtu është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave që parashtrohen nga komunitetet ose pjesëtarët e tyre, nëse aktet a vendimet e Kuvendit të Komunës shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Zëvendëskryetari këto çështje ia referon Kuvendit të Komunës, për rishqyrtimin e aktit a të vendimit të marrë.

4. Në rast se Kuvendi i Komunës vendos që të mos rishqyrtojë aktin a vendimin e vet, ose nëse zëvendëskryetari vlerëson se, edhe pas rishqyrtimit rezultati përbën shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ai/ajo mund të parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do të pranojë ta shqyrtojë rastin përkatës”.

44. Gjykata vëren gjithashtu se LVL, përkatësisht paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 55 (Detyrat e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete) të tij, përmbajnë dispozita relevante dhe të cilat përcaktojnë si në vijim:

“55.2. Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të komuniteteve apo pjesëtarëve të tyre, në mënyrë që aktet apo vendimet e Kuvendit të Komunës të mos i shkelin të drejtat e garantuara kushtetuese të tyre.

55.3. Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete, aktet apo vendimet e tilla ia paraqet Kuvendit të Komunës për rishqyrtim.

55.4 Në rast se Kuvendi i Komunës nuk e shqyrton aktin apo vendimin, ose Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës konsideron se rezultati, pas rishqyrtimit, ende paraqet shkelje të të drejtave të garantuara kushtetuese, ai mund ta parashtrojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese e cila mund të vendosë për pranimin e çështjes për shqyrtim”.

45. Për më tepër, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 79 të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

[Kërkesa në pajtim me nenin 62.4 të Kushtetutës]

(1) Zëvendëskryetari i Kuvendit të Komunës që parashtron kërkesë duhet të tregojë se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë janë shkelur.

(2) Kërkesa paraqitet jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pasi që është marrë vendimi përfundimtar i kontestuar i Kuvendit të Komunës.

(3) Në rast se Kuvendi i Komunës nuk e rishqyrton kërkesën brenda një periudhe të arsyeshme kohore, Gjykata do të konsiderojë se është marrë vendimi përfundimtar”.

46. Bazuar në dispozitat e lartreferuara, Gjykata vëren se dispozitat përkatëse të Kushtetutës, LVL-së dhe Rregullores së punës, përcaktojnë katër kritere procedurale që duhet të përmbushen në mënyrë që kërkesa e Zëvendëskryetarit për Komunitete të Kuvendit Komunal drejtuar Gjykatës, të kaloj testin e pranueshmërisë. (Shih në këtë kontekst gjithashtu rastin e Gjykatës KI32/10, parashtrues i kërkesës *Fahrudin Megjedović*, Aktgjykimi i 14 marsit 2011).
47. Më specifikisht, një kërkesë e dorëzuar në Gjykatë bazuar në paragrafin 3 dhe 4 të nenit 62 të Kushtetutës duhet t'i plotësoj kriteret në vijim: (i) nxjerrja e aktit ose vendimit; (ii) kërkesa për “*rishqyrtimin*” e këtij akti ose vendimi; (iii) veprimi ose mosveprimi i Kuvendit Komunal si rezultat i kësaj kërkesë për “*rishqyrtim*”; dhe (iv) afatshmëria e kërkesës së paraqitur në Gjykatë.
48. Kriteri i parë procedural është që Kuvendi Komunal të ketë marrë ndonjë vendim ose akt. Ky kriter është i përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 62 të Kushtetutës.
49. Kriteri i dytë procedural është kërkesa për “*rishqyrtim*” e Zëvendëskryetarit për Komunitete drejtuar Kuvendit Komunal në rast se ai/ajo ose/dhe komunitetet ose pjesëtarët e tyre konsiderojnë se aktet ose vendimet e tilla shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Ky kriter është i përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 62 të Kushtetutës.
50. Kriteri i tretë procedural është veprimi ose mosveprimi i Kuvendit Komunal pas kërkesës për “*rishqyrtim*” të Zëvendëskryetarit për Komunitete. Më specifikisht, Zëvendëskryetari për Komunitete mund t'i drejtohet Gjykatës me pretendimet për shkelje të të drejtave të komuniteteve joshumicë, në rast se (i) Kuvendi Komunal nuk ka shqyrtuar kërkesën për “*rishqyrtimin*” e aktit ose vendimit; ose (ii) Kuvendi Komunal ka shqyrtuar kërkesën për “*rishqyrtimin*” e aktit ose vendimit dhe rezultati i këtij “*rishqyrtimi*” edhe më tej pretendohet të konsistojë në shkelje të të drejtave kushtetuese të komuniteteve joshumicë. Ky kriter është i përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 62 të Kushtetutës.

51. Kriteri i katërt procedural është afatshmëria e kërkesës së paraqitur në Gjykatë. Rregullorja e punës përcakton që ky afat është 6 (gjashtë) muaj pasi që është marrë vendimi përfundimtar i kontestuar i Kuvendit Komunal. Rregullorja e punës nuk përcakton afate sa i përket paraqitjes së kërkesës për “*rishqyrtim*” në Kuvendin Komunal nga Zëvendëskryetari për Komunitete apo edhe sa i përket periudhës kohore në dispozicion për Kuvendin Komunal për të shqyrtuar një kërkesë të tillë. Megjithatë, Rregullorja e punës përcakton që periudha kohore duhet të jetë “*e arsyeshme*” dhe se, nëse Kuvendi Komunal nuk vepron brenda kësaj periudhe, vendimi përfundimtar do të konsiderohet të jetë marrë.
52. Për më tepër, Gjykata vëren se këto katër kritere procedurale duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Plotësimi i tyre është parakusht për pranueshmërinë e kërkesës. Megjithatë edhe në këto rrethana, Kushtetuta i jep Gjykatës diskrecion në pranimin e një kërkesë të tillë për shqyrtim. Ky diskrecion është i përcaktuar përmes paragrafit 4 të nenit 62 të Kushtetutës.
53. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë përmbushjen e këtyre katër kritereve procedurale të pranueshmërisë në rrethanat e rastit konkret, përkatësisht (i) marrjen e aktit ose vendimit nga Kuvendi Komunal; (ii) kërkesën për “*rishqyrtim*” të Zëvendëskryetarit për Komunitete; (iii) veprimin ose mosveprimin e Kuvendit Komunal; dhe (iv) afatin kohor brenda të cilit duhet të dorëzohet një kërkesë e tillë në Gjykatë.
54. Gjykata do të fillojë shqyrtimin e këtyre kritereve duke filluar nga ky i fundit, përkatësisht afati kohor për dorëzimin e kërkesës në Gjykatë, sepse, i njëjti ka pësuar ndryshime pas dorëzimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës në Gjykatë dhe para shqyrtimit të saj, si rezultat i ndryshimit të Rregullores së punës më 31 maj 2018.
55. Më specifikisht, Gjykata shënon se afati kohor prej 6 (gjashtë) muajsh për dorëzimin e kërkesave në pajtim me paragrafin 4 të nenit 62 të Kushtetutës, është përcaktuar nga Gjykata përmes miratimit të rregullores së re të punës. Rregullorja paraprake e punës, përkatësisht ajo e ndryshuar dhe miratuar në vitin 2015, nuk ka përcaktuar një afat të tillë kohor. Rrjedhimisht, dhe pa paragjykim nëse në rrethanat e rastit konkret “*është marrë vendimi përfundimtar i kontestuar i Kuvendit të Komunës*”, moment ky prej të cilit, sipas Rregullores së punës në fuqi, fillon të rrjedh afati 6 (gjashtë) muaj, Gjykata në rrethanat e rastit konkret, do të aplikoj Rregulloren paraprake të punës, të aplikueshme në kohën kur është dorëzuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës, dhe e cila nuk përcakton afat kohor për dorëzimin e kërkesave mbi bazën e paragrafit 4 të nenit 62 të Kushtetutës, si Rregullore më e favorshme për parashtruesin e kërkesës në rrethanat e rastit konkret. Rrjedhimisht, Gjykata kërkesën e parashtruesit të kërkesës do ta trajtojë si të afatshme.
56. Më tej, Gjykata do t’i shqyrtojë tri kriteret e mbetura të pranueshmërisë, (i) marrjen e aktit ose vendimit nga Kuvendi Komunal; (ii) kërkesën për “*rishqyrtim*” të

Zëvendëskryetari për Komunitete; dhe (iii) veprimin ose mosveprimin e Kuvendit Komunal, respektivisht.

57. Përkitazi me kriterin e parë, Gjykata rikujton që Kuvendi Komunal kishte nxjerrë dy Vendime në vitin 2012, Vendimin [01. nr. 06-368/1] e 21 marsit dhe Vendimin [01. nr. 06-1281/1] e 8 gushtit, respektivisht, përmes të cilave shpalli interesin e përgjithshëm dhe përcaktoi shpronësimin e një numri të parcelave kadastrale me qëllim të ndërtimit të hidrocentraleve në fshatrat përkatëse të Komunës së Dragashit nga Konsorciumi “Eurokos JH & Loreto Consult AG” Zug – Zvicër”. Këto Vendime ishin vlerësuar si të ligjshme nga departamenti përkatës i MAPL-së. Në vitin 2015, Kryetari i Kuvendit Komunal kishte nxjerrë edhe Vendimin [04. nr. 463-22/2012] për shpronësimin e pronave përkatëse, duke u bazuar në Vendimet e kontestuara.
58. Gjykata rikujton gjithashtu se këto Vendime ishin kontestuar në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prizren dhe në Gjykatën Supreme. Gjykata Themelore në Prizren, sipas shkresave të lëndës, përmes Aktvendimit [CN. nr. 59/17], kishte refuzuar kërkesën për masë të përkohshme. Megjithatë, nga shkresat e lëndës nuk rezulton nëse Gjykata Themelore në Prizren dhe Gjykata Supreme të kenë vendosur për meritat e çështjes. Në këtë aspekt, Gjykata megjithatë vëren se duke marrë parasysh që kërkesa e parashtruesit të kërkesës në Gjykatë është dorëzuar bazuar në paragrafin 4 të nenit 62 të Kushtetutës, procedurat para gjykatave të rregullta përkitazi me vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimeve të kontestuara, nuk janë objekt shqyrtimi në rrethanat e rastit konkret para Gjykatës.
59. Në Gjykatë kontestohen dy Vendimet e Kuvendit Komunal të vitit 2012, Vendimi [01.nr.06-368/1] i 21 marsit dhe Vendimi [01. nr. 06-1281/1] i 8 gushtit, respektivisht, duke plotësuar kështu kriterin e parë procedural për vlerësimin e pranueshmërinë së kërkesës nga Gjykata, të përcaktuar përmes paragrafit 3 të nenit 62 të Kushtetutës.
60. Rrjedhimisht në vijim, Gjykata do të shqyrtoj plotësimin e kriterit të dytë të pranueshmërisë, përkatësisht nëse në rrethanat e rastit konkret, Zëvendëskryetari për Komunitete ka kërkuar nga Kuvendi Komunal “*rishqyrtimin*” e Vendimeve të kontestuara. Gjykata thekson se bazuar në paragrafin 3 të nenit 62 të Kushtetutës, Zëvendëskryetari për Komunitete kërkon nga Kuvendi Komunal “*rishqyrtimin*” e aktit ose vendimit të nxjerrë, nëse i njëjti pretendohet të shkelë të drejtat e komuniteteve joshumicë të garantuara me Kushtetutë.
61. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se Vendimet e kontestuara ishin marrë në vitin 2012. Sipas shkresave të lëndës dhe pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, këto Vendime nuk ishin kontestuar në Kuvendin Komunal. Më specifikisht, Zëvendëskryetari për Komunitete nuk i kishte dorëzuar Kuvendit Komunal një kërkesë për “*rishqyrtimin*” e këtyre Vendimeve në kuptimin e paragrafit 3 të nenit 62 të Kushtetutës.

62. Pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale në vitin 2013, me ç'rast ishte ndërruar përbërja e Kuvendit Komunal, në vitin 2015, Kryetari i Komunës, bazuar në po të njëjtat Vendime, kishte nxjerrë edhe Vendimin [04. nr. 463-22/2012] për shpronësimin e pronave të afektuara të paluajtshme. Sipas shkresave të lëndës dhe pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ky Vendim nuk ishte kontestuar në Kuvendin Komunal. Më specifikisht, Zëvendëskryetari për Komunitete nuk i kishte dorëzuar Kuvendit Komunal një kërkesë për "*rishqyrtimin*" e këtij vendimi në kuptimin e paragrafit 3 të nenit 62 të Kushtetutës.
63. Gjykata për më tepër, vëren që përkundër faktit që ajo dy herë ka kërkuar nga parashtruesi i kërkesës provat përkatëse që do të vërtetonin që parashtruesi i kërkesës kishte bërë një kërkesë për "*rishqyrtim*" përkitazi me Vendimet e kontestuara në Kuvendin Komunal, një dëshmi e tillë nuk është dorëzuar në Gjykatë. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të konstatojë, se në rrethanat e rastit konkret, nuk është përmbushur kriteri i dytë procedural i përcaktuar përmes paragrafit 3 të nenit 62 të Kushtetutës përkitazi me kërkesën për "*rishqyrtim*".
64. Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës në Gjykatë ka dorëzuar kërkesën përkatëse për seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të 21 qershorit 2017, duke kërkuar anulimin e (i) Vendimit [01. nr. 06-368/1] të 21 marsit 2012 të Kuvendit Komunal; (ii) Vendimit [01. nr. 06-1281/1] të 8 gushtit 2012 të Kuvendit Komunal; dhe (iii) Vendimit [04. nr. 463-22/2012] të 10 marsit 2015 të Kryetarit të Komunës për shpronësimin e pronave përkatëse, për shkak të "*situatës së re të krijuar në fshatin Vraniq me rastin e ndërtimit të hidrocentralit*".
65. Megjithatë, Gjykata thekson se kërkesa e vitit 2017 për seancë të jashtëzakonshme përmes të cilës është kërkuar anulimi i Vendimeve të kontestuara, nuk mund të konsiderohet kërkesë për "*rishqyrtim*" në kuptim të paragrafit 3 të nenit 62 të Kushtetutës sepse (i) kjo kërkesë duhet të ndërlidhet me shkelje të pretenduara të të drejtave të komuniteteve si rezultat i nxjerrjes së aktit ose vendimit të Kuvendit Komunal; dhe (ii) nuk mund të ndërlidhet me "*rrethanat e reja*" e të krijuara në fshatin Vranishtë 5 (pesë) vite pasi janë nxjerrë Vendimet e kontestuara. Gjykata rikujton që bazuar në shkresat e lëndës, anulimi i Vendimeve të kontestuara nuk ishte kërkuar sepse të njëjtat janë nxjerrë në shkelje të të drejtave kushtetuese të komuniteteve joshumicë, por për shkak të "*rrethanave të reja*" të krijuara në njërin nga fshatrat e afektuara përmes Vendimeve të kontestuara. Si rezultat, kërkesa për seancë të jashtëzakonshme e vitit 2017, nuk mund të konsiderohet si kërkesë për "*rishqyrtim*" të Vendimeve të kontestuara të vitit 2012, në kuptim të paragrafit 3 të nenit 62 të Kushtetutës.
66. Gjykata rikujton që plotësimi i kriterëve për pranueshmërinë e kërkesës në kuptimin e paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 62 të Kushtetutës është kumulativ dhe rrjedhimisht, nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse në rrethanat e rastit konkret plotësohet edhe kriteri i tretë procedural, përkatësisht veprimi ose mosveprimi i Kuvendit Komunal si rezultat i një kërkesë për "*rishqyrtim*". Megjithatë, Gjykata rikujton që Kuvendi Komunal gjatë seancës së jashtëzakonshme të 23 qershorit 2017, kishte shqyrtuar "*situatën e re të krijuar në*

fashtin Vraniq” dhe kishte vendosur, me shumicë votash, kundër propozimit për anulimin e vendimeve të kontestuar.

67. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata konkludon se në rrethanat e rastit konkret, kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, specifikisht sepse ajo dështon të përmbush kriterin e dytë procedural të pranueshmërisë të ndërlidhur me kërkesën për “*rishqyrtim*” të parashtruar nga Zëvendëskryetari për Komunitete kundër aktit ose vendimit të Kuvendit Komunal.
68. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk është e pranueshme për shqyrtim në pajtim me nenin 62 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 3 dhe 4 të nenit 62 të Kushtetutës, në seancën e 22 korrikut 2019 me shumicë:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka Nimani
Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi